




REPUBLICA E SHQIPERISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
BORDI I ADMINISTRIMIT



Nr. .... Prot.

Vlorë, më 14.07.2017

**Vendim**  
**Nr. 20, datë 14.07.2017**

**PËR PËRJASHTIMIN NGA TARIFA E MBETUR E SHKOLLIMIT TË STUDENTES UJEZA FEJZAJ**

Bazuar në vendimin nr. 269, pika 2, datë 29.03.2017, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit", shkresës me nr. 5171 Prot, datë 17.05.2017 "Për vlerësimin me prioritet të studentëve të kategorive sociale në nevojë, si dhe studentëve ekselentë që ndjekin studimet në ciklin e dytë në vitin akademik 2016-2017" të Ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe në dokumentacionin relatives, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 14.07.2017

**KONSTATON SE:**

Pranë Bordit të Administrimit është paraqitur kërkesa/shkresa me nr. 976, datë 13.07.2017 e Zv. Rektorit të Universitetit "Ismael Qemali", Vlorë nëpërmjet të cilës është kërkuar përjashtimi nga tarifa e mbetur e shkollimit të studentes Ujeza Fejzaj me argumentimin se ajo është studente e ekselencës. Bashkangjitur kësaj shkrese janë paraqitur dhe kërkesa e vetë studentes për shtyrjen e pagesës së tarifës së shkollimit, vërtetimi që ajo është studente në Universitetin "Ismael Qemali", Vlorë si dhe vërtetimi i listës së notave.

Bordi i Administrimit pasi shqyrtoi dokumentat dhe përmbajtjen e shkresës me nr. 976, datë 13.07.2017 e Zv. Rektorit të Universitetit "Ismael Qemali", Vlorë konstatoi se kërkesa është e pabazuar në ligj dhe për këtë arsye ajo duhet të rrëzohet pasi është paraqitur jashtë çdo afati të përcaktuar në vendimin nr. 269, pika 2, datë 29.03.2017, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit", shkresës me nr. 5171 Prot, datë 17.05.2017 "Për vlerësimin me prioritet të studentëve të kategorive sociale në nevojë, si dhe studentëve ekselentë që ndjekin studimet në ciklin e dytë në vitin akademik 2016-2017" të Ministrit të Arsimit dhe Sportit.

Duke qenë se këto afate kanë karakter prekluziv dhe nuk mund të shtyhen nga ana e Bordit të Administrimit, kërkesa e paraqitur nga Zv. Rektori i Universitetit "Ismael



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Qemali", Vlorë nuk mund të pranohet. Për këtë arsye në përfundim Bordi i Administrimit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë,

**VENDOSI:**

1. Rrëzimin e kërkesës së Zv. Rektorit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë për të përjashtuar nga tarifa e mbetur e shkollimit studenten Ujeza Fejzaj.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Një kopje e këtij vendimi i komunikohet Zv. Rektorit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.

1. Rezana Vrapi – Kryetar

2. Florian Nurçe – anëtar

3. Enida Pulaj – anëtar

4. Eduard Ahmeti – anëtar

5. Elsajed Rexhaj – anëtar

SEKRETARI:

OLSI VANGJELI

Ky dokument përpilohet në 3 (tre) kopje.